

K O N K L U Z I O N

Nr.09-644/1 dt. 22.06.2016

**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR VENDOSJEN E
BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL ME KOMUNAT VEVÇAN,
QENDËR ZHUPË, OHËR, DEBËRCË, STRUGË, PLASNICË,
KËRÇOVË DHE MAKEDONSKI BROD**

568.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, me komunat Vevçan, Qendër Zhupë, Ohër, Debrçë, Strugë, Plasnicë, Kërçovë dhe Makedonski Brod, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.08-623/3 dt.20.06.2016

**PËR VENDOSJEN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL ME
KOMUNAT VEVÇAN, QENDËR ZHUPË, OHËR, DEBËRCË, STRUGË,
PLASNICË, KËRÇOVË DHE MAKEDONSKI BROD**

569.Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 3 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal (“Gazeta zyrtare në RM”, nr. 79/09) , dhe neni 59 të Statutit të Komunës (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr. 14/03), pas vlerësimit paraprak për nevojën e vendosjes së bashkëpunimit ndërkomunal,

Këshilli i Komunës Dibër, në seancën e 37^{të} dt.20.06.2016, vendosi:

Neni 1

Me këtë Vendim vendoset bashkëpunimi ndërkomunal, me komunat e Vevçanit, Qendrës Zhupë, Ohrit, Debërcës, Strugës, Plasnicës, Kërçovës dhe Makedonski Brodit për kryerjen e kompetencave më mënyrë sa me efikase në sferën e zhvillimit ekonomik lokal për promovimin dhe mbështetjen e zhvillimit rural në rajonin planor Jugperëndimor.

Neni 2

Bashkëpunimi ndërkomunal nga neni 1 i vendimit do të realizohet përmes Rrjetit inkluziv për zhvillim rural në rajonin planor Jugperëndimor – RRIZHR si trup pune i përhershëm dhe e përbashkët e komunave nga rajoni planor Jugperëndimor.

Neni 3

Trupi i përhershëm punues – RRIZHR përbëhet nga një përfaqësues nga:

- Njësitë për zhvillim ekonomik lokal të ç’do komune e cila ka vendosur bashkëpunim ndërkomunal;
- Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor;
- Fakulteti për turizëm dhe hoteleri – Ohër pranë Universitetit “ Shën Kliment Ohridski” – Manastir;
- Oda ekonomike e Maqedonisë, Oda ekonomike rajonale me seli në Kërçovë;
- Tur- operator nga RPJP;
- OJQ nga RPJP;
- Grupi aksioner rajonale (GAR)
- Shoqata e ciceronëve turistikë – Ohër;

- Agjencioni për promovim dhe mbështetje të turizmit – njësitë rajonale në RPJP;
- Agjencioni për financim dhe mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural njësitë rajonale në RPJP dhe përfaqësues nga
- Klasteri për turizëm nga Ohri.

Sipas nevojës, pa të drejtë vendosje në punën e trupës punuese të përhershme dhe të përbashkët mundet të kyçen dhe përfaqësues nga institucionet nacionale dhe organizatat ndërkombëtare

Neni 4

Si përfaqësues në trupin e përhershëm punues nga Komuna e Dibrës propozohet z. Arbëror Basha me titull këshilltar për ZHEL.

Neni 5

Autorizohet kryetari i këshillit të Komunës së Dibrës taë nënshkruaj vendimin për formimin e trupit të punës të përhershëm dhe të përbashkët – Rrjeti inkluziv për zhvillim rural në rajonin planor Jugperëndimor - RRIZHR.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të shpallet në Kumtesën zyrtare të Komunës së Dibrës.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.09-644/2 dt. 22.06.2016
PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR SJELLJEN E PLANIT DETAL
URBANISTIK PËR PJESE QËNDRORE TË QYTETIT BU - 3
NË KOMUNËN DIBËR

570.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për sjelljen e Planit Detal Urbanistik për pjesë qendrore të qytetit BU - 3 në Komunën Dibër, sjellur nga Këshilli i Komunës në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

571.Në mbështetje të nenit 26 të Ligjit për planifikim urbanistik dhe hapsinor (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 51/05, 137/07, 91/09,124/10, 18/11, 53/11,144/12, 55/13, 163/13 dhe 42/14), nenit 22, paragrafi 1, pika 1 , nenit 36 të Ligjit për vetadministrim lokal (“Gazeta zyrtare e RM”nr.5/02) si dhe nenit 27 paragrafi 1 pika 7 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër “ nr. 14/03),

Këshilli i Komunës të Dibër në seancën e 37^{te} datë 20.06.2016 solli :

V E N D I M
PËR SJELLJEN E PLANIT DETAL URBANISTIK
PËR PJESË QËNDRORE TË QYTETIT BU - 3
NË KOMUNËN DIBËR

Neni 1

Sjelllet PLANI DETAL URBANISTIK për pjesë qendrore të qytetit BU - 3 në Komunën Dibër me sipërfaqe prej 4,50 ha , e përkapur brenda këtyre kufinjve: veri – rruga “Rruga e re e planifikuar “ , lindje-rruga “8-të Shtatori “ , perëndim-rruga “ Rruga e re e planifikuar “ dhe jug - rruga “ 100 “ (Bulevari ”Ilirija “).

Neni 2

Plani nga neni 1 i këtij Vendimi është i përpiluar nga “TAJFA PLAN “ shpk – Shkup me numër teknik 038/06/14 , dhe përmban pjesën tekstuale dhe grafike.

Neni 3

Plani verifikohet në afat prej 8 (tetë) ditë nga dita e sjelljes, në 7 (shtatë) ekzemplarë dhe ju dërgohen shërbimeve dhe organeve shtetërore përkatëse.

Neni 4

Planin do ta zbatojë organi kompetent i Komunës Dibër.

Neni 5

Ky Vendim me një ekzemplar të verifikuar të Planit i dorëzohet Organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër .

Nr.08-623/4
20.06.2016
D i b ë r

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-644/3 dt. 22.06.2016

**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR
SJELLJEN E DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR
HARMONIZIM TË DESTINIMIT TË PJESE TË TOKËS NDËRTIMORE
PËR PK NR. 817/1 KK RAJÇICË**

572.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore **për PK nr. 817/1 KK Rajçicë**, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M
Nr.08-623/5 dt.20.06.2016
PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR SJELLJEN E
DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR HARMONIZIM
TË DESTINIMIT TË PJESE TË TOKËS NDËRTIMORE PËR
PK NR. 817/1 KK RAJÇICË

573.Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/11, 54/11, 155/12, 72/13, 44/14, 115/14, 199/14, 124/15, 129/15, 217/15 dhe 31/16), nenit 2 paragrafi 1 alineja 5 të Rregullores për standarde për përshtatjen e objekteve të ndërtuara pa leje në dokumentacionin urbanistik planor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 56/11, 162/12, 95/13, 109/14 64/15, 217/15 dhe 52/16), dhe nenit 27 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr. 14/03),

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016, vendosi:

Neni 1

Përcaktohet nevoja për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për harmonizim të destinimit të tokës ndërtimore, për përcaktimin e statusit juridik të objektit pa leje, objekti nr.2, objekt garazhë me destinim G tip (Pr) e cila është ndërtuar në PK nr. 243 dhe pjesë prej 5m² në PK nr.817/1 KK RAJÇICË, objekti është pronë e Ramazan Capa nga Dibra.

Sipas Planit gjeneral urbanistik për qytetin Dibër, toka ku është ndërtuar objekti është parapa me destinim gjelbërim mbrojtës i rrugës GjMRr por pasi që ajo pjesë është organizuar si vendbanim parametrat e gjelbërimit mbrojtës të rrugës ndryshohen me trotoar.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë, nga dita e shpalljes në „Kumtesën zyrtare,, të Komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetar,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-644/4 dt. 22.06.2016

**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR
SJELLJEN E DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR
ZGJËRIM TË KUFIRIT TË PLANIT DHE INKORPORIM TË
OBJEKTIT PA LEJE NË PK NR. 3728 KK DIBËR-JASHT REONI**

574.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për zgjerim të kufirit të Planit dhe inkorporim të objektit pa leje në **PK nr.3728 KK Dibër-jasht rajonit**, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.08-623/6 dt.20.06.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR SJELLJEN E
DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR ZGJËRIM TË
KUFIRIT TË PLANIT DHE INKORPORIM TË OBJEKTIT PA LEJE NË
PK NR. 3728 KK DIBËR-JASHT REONI**

575.Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/11, 54/11, 155/12, 72/13, 44/14, 115/14, 199/14, 124/15, 129/15, 217/15 dhe 31/16), nenit 2 paragrafi 2 të Rregullores për standarde për përshtatjen e objekteve të ndërtuara pa leje në dokumentacionin urbanistik planor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 56/11, 162/12, 95/13, 109/14 64/15, 217/15 dhe 52/16), dhe nenit 27 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr. 14/03),

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016, vendosi:

Neni 1

Përcaktohet nevoja për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për zgjerim të kufirit të planit dhe inkorporim të objektit pa leje në PK nr. 3728 KK Dibër-jasht reoni objekt ndihmës destinim N - (P+K1) prone e Gani Sodolit.

Sipas PGjU në fuqi për qytetin Dibër, toka në PK nr. 3728 KK Dibër-jasht reoni është pronë e Gani Sodolit dhe e njejta gjendet në jashta kufirit planor.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë, nga dita e shpalljes në „Kumtesën zyrtare,, të Komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetar,

Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-644/5 dt. 22.06.2016

**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR
SJELLJEN E DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR
HARMONIZIM TË DESTINIMIT TË PJESE TË TOKËS NDËRTIMORE
PËR PK NR. 10713/3 KK DIBËR-3**

576.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore në **PK nr.10713 KK Dibër-3**, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.08-623/7 dt.20.06.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR SJELLJEN E
DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR PËR HARMONIZIM
TË DESTINIMIT TË PJESE TË TOKËS NDËRTIMORE PËR
PK NR. 10713/3 KK DIBËR-3**

577.Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/11, 54/11, 155/12, 72/13, 44/14, 115/14, 199/14, 124/15, 129/15, 217/15 dhe 31/16), nenit 2 paragrafi 1 alineja 5 të Rregullores për standarde për përshtatjen e objekteve të ndërtuara pa leje në dokumentacionin urbanistik planor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 56/11, 162/12, 95/13, 109/14 64/15, 217/15 dhe 52/16), dhe nenit 27 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr. 14/03),

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016, vendosi:

Neni 1

Përcaktohet nevoja për sjelljen e dokumentacionit urbanistik planor për harmonizim të destinimit të tokës ndërtimore, për përcaktimin e statusit juridik të objekteve pa leje, objekti nr.6, 8 dhe 12 objekte për industri të lehtë jondotëse me destinim G2-6 - tip (Pr) që janë ndërtuar në PK nr. 10713/3 KK DIBËR-3, objektet janë pronë e personit juridik RA „MEDINA-HM,, SHPKNJP nga Dibra.

Sipas Planit gjeneral urbanistik për qytetin Dibër, toka ku janë ndërtuar objektet është parapa me destinim gjelbërim mbrojtës D2.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë, nga dita e shpalljes në „Kumtesën zyrtare,, të Komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetar,

Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-644/6 dt. 22.06.2016

**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR VENDOSJEN E PARTNERITET
MES KOMUNËS DIBËR, REPUBLIKA E MAQEDONISË DHE
KOMUNËS ADAPAZAR, REPUBLIKA E TURQISË**

578.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për vendosjen e partneritetit mes Komunës Dibër, Republika e Maqedonisë dhe Komunës Adapazar, Republika e Turqisë, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr. 08-623/8 dt. 20.06.2016

**PËR VENDOSJEN E PARTNERITET MES KOMUNËS DIBËR,
REPUBLIKA E MAQEDONISË DHE
KOMUNËS ADAPAZAR, REPUBLIKA E TURQISË**

579.Në mbështetje të nenit 14 paragrafi 4 dhe 5 e në lidhje me nenin 36 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për vetqeverisje lokale (”Gazeta Zyrtare e RM”nr.05/02), si dhe nenit 13 të Statutit të Komunës (”Kumtesa zyrtare e Komunësnr 14/3),

Këshilli i Komunës së Dibrës në seancën e 37^{të} dt. 20.06.2016 vendosi:

Neni 1

Me këtë vendim Komuna e Dibrës, Republika e Maqedonisë vendos marrëdhënie partneriteti me Komunën Adapazar, Republika e Turqisë, me ç’ka do të realizohet bashkëpunimi i ndërsjellë në bazë të dëshirës dhe interesit të përbashkët.

Neni 2

Partneriteti i këtyre dy Komunave paraqet akt zyrtar dhe solemn të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërkomunal në zhvillimin e dy Komunave.

Neni 3

Partneriteti ndërkombëtar dhe ndërkomunal nënkupton bashkëpunim të dy njësive të vetqeverisjes lokale, në drejtim të shkëmbimit të mendimeve, ideve dhe përvojave përmes vizitave dhe kontakteve të ndërsjellta të delegacioneve dhe përfaqësuesve të komunave si dhe realizimit të manifestimeve kulturore, sportive, muzikore, arsimore dhe manifestimeve të tjera.

Vëllimi, lloji dhe mënyra e bashkëpunimit do të përcaktohet me anë të nënshkrimit të Protokollit për partneritet mes komunave.

Neni 4

Autorizohet Kryetari i Komunës së Dibrës që të ndërmarë të gjitha aktivitetet e nevojshme, si dhe të nënshkruajë Protokollin për partneritet mes Komunës së Dibrës Republika e Maqedonisë dhe Komunës Adapazar, Republika e Turqisë .

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në ”Kumtesën zyrtare të Komunës ”

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetari,

Bashkim Mashkulli d.v.

P Ë R M B A J T J A

568	Konkluzion për shpallje të vendimit për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, me komunat Vevçan, Qendër Zhupë, Ohër, Debrçë, Strugë, Plasnicë, Kërçovë dhe Makedonski Brod	_____	1086
569	Vendim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal, me komunat Vevçan, Qendër Zhupë, Ohër, Debrçë, Strugë, Plasnicë, Kërçovë dhe Makedonski Brod	_____	1087
570	Konkluzion për shpallje të vendimit për sjelljen e Plani Detal Urbanistik për pjesë qendrore të qytetit BU - 3 në Komunën Dibër	_____	1089
571	Vendim për sjelljen e Plani Detal Urbanistik për pjesë qendrore të qytetit BU - 3 në Komunën Dibër	_____	1090
572	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore për PK nr. 817/1 KK Rajçicë	_____	1091
573	Vendim për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore për PK nr. 817/1 KK Rajçicë	_____	1092
574	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për zgjerim të kufirit të Planit dhe inkorporim të objektit pa leje në PK nr.3728 KK Dibër-jasht rajonit	_____	1093
575	Vendim për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për zgjerim të kufirit të Planit dhe inkorporim të objektit pa leje në PK nr.3728 KK Dibër-jasht rajonit	_____	1094
576	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore në PK nr.10713 KK Dibër-3	_____	1095
577	Vendim për përcaktimin e nevojës për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për harmonizim të destinimit të pjese të tokës ndërtimore në PK nr.10713 KK Dibër-3	_____	1096
578	Konkluzion për shpallje të vendimit për vendosjen e partneritetit mes Komunës Dibër, Republika e Maqedonisë dhe Komunës Adapazar, Republika e Turqisë	_____	1097
579	Vendim për vendosjen e partneritetit mes Komunës Dibër, Republika e Maqedonisë dhe Komunës Adapazar, Republika e Turqisë	_____	1098